



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 18 shtator 2017, në mbledhjen e XLII - të (dyzetedy) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Driton Nuli, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Kumrie Hoti, theksoi, në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2017, kam kërkuar që për mbledhjen e radhës në rend dite të përfshihet Informata për gjendjen në shëndetësi, Ju zotëri kryesues thatë se në rendin e propozuar të ditës janë përfshirë çështjet më të rëndësishme, por unë nuk jam në dijeni se a ka diç më të rëndësishme se shëndeti i njeriut, andaj do duhej të kemi informacione rreth ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar.

Këtë informatë e kam kërkuar katër vite me radhë, mirëpo kjo kërkesë e imja nuk është marrë në konsideratë gjatë gjithë këtyre viteve, andaj unë kërkoj përgjigje përse nuk paraqitet kjo informatë, por fatkeqësisht nuk mund ta marr përgjigjen ngase drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk është i pranishëm në mbledhje. Nga arsyeja e cekur unë nuk mund ta mbështes këtë rend të ditës ngase kërkesa ime është e arsyeshme dhe se Informata e cekur është e paraparë edhe në Planin e punës të Kuvendit për vitin 2017.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, jeni në dijeni se të gjitha materialet e propozuara nga Ekzekutivi i Komunës i procedoj për shqyrtim në Kuvend, përndryshe rendi i propozuar për këtë mbledhje, kuptohet edhe për mbledhjen e Kuvendit është mjaftë i ngarkuar, mirëpo sa i përket propozimit të parafolës nuk jam në dijeni përse kjo informatë nuk është propozuar për shqyrtim.

z. Haki Rudari, theksoi, natyrisht unë nuk pajtohem me rendin e propozuar të ditës ngase kemi disa shkelje të Planit të punës së Kuvendit, gjithashtu rendi i ditës është shumë i ngarkuar dhe jam i mendimit se mënyra e kështu nuk është e mirë, unë e kam përcjellë punën e disa Kuvendeve të Komunave të tjera në të cilat mbledhjet për këto çështje i kanë mbajtur më herët dhe nga kjo shqyrtimin dhe diskutimin për materialet përkatëse e kanë pasë më të lehtë.

Pra Plani i punës të Kuvendit nuk është respektuar, janë disa çështje mjaft të rëndësishme që gjithsesi është dashtë më herët të shqyrtohen ndërsa rendi i ditës për mbledhjen e sotme është i stërngarkuar, andaj kjo është arsyeja që nuk mund ta mbështes rendin e propozuar të ditës për këtë mbledhje.

z. Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë se materialet e propozuara për shqyrtim në këtë mbledhje janë voluminoze, materiale të cilat kërkojnë trajtim serioz, mirëpo duke u bazuar se jemi para fushatës zgjedhore, pra në fund të mandatit, jam i mendimit se mund ta mbështesim këtë rend të propozuar të ditës, edhe pse jam i mendimit se rendi i ditës është mjaft i ngarkuar.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, gjatë debatit u përmend se nuk është respektuar Plani i punës i Kuvendit, lidhur me këtë lirshëm mund të them se Plani i punës, përveç dy çështjeve është përmbush në tërësi.

Raporti i Auditorit të Përgjithshëm është në Web faqen zyrtare të Komunës, por jeni në dijeni se vazhdimisht e kemi shqyrtuar edhe në Kuvend, mirëpo nëse këtë material apo eventualisht edhe ndonjë material tjetër e heqim nga rendi i ditës është pikëpyetje e madhe se a do të kemi mundësi të mbajmë edhe ndonjë mbledhje tjetër ngase për pak ditë fillon fushata zgjedhore.

Nëse në ndërkohë paraqitet ndonjë material nga Drejtoritë, në konsultim me Zyrën Ligjore, nuk do të hezitoj të thirr mbledhje të Kuvendit edhe gjatë kohës së fushatës zgjedhore.

z. Haki Rudari, theksoi, për rendin e propozuar të ditës u deklarova në diskutimin e mëhershëm, mirëpo për atë se a do të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i një apo disa materialeve, për këtë sipas mendimit tim duhet të vendosim me konsensus.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, pajtohem se rendi i ditës është mjaft i ngarkuar por gjithsesi duhet të pajtohem se thirrja dhe materiali për këtë mbledhje dhe mbledhjen e Kuvendit janë dërguar me kohë. Pajtohem edhe për atë se për të dhënë kontributin e nevojshëm gjatë shqyrtimit të këtyre materialeve e në veçanti për propozimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale, nevojitet kohë dhe punë intensive. Sa i përket rendit të propozuar të ditës, përkatësisht se a të hiqet apo jo ndonjë material, për këtë nuk duhet të polemizojmë por të vendosim përmes votimit në bazë të propozimeve konkrete.

Kolegia z. Kumrie Hoti, ka shumë të drejtë dhe pajtohem plotësisht me te që paraqiti vërejtje për Informatën lidhur me gjendjen në shëndetësi, Informatë e cila ka kohë që disa herë është kërkuar, por përkundër kësaj nuk është paraqitur për shqyrtim në Kuvend.

Gjithashtu është dashtë të paraqitet edhe Informata për fillimin e vitit të ri shkollor.

Jam i mendimit se mund të përgatiten disa materiale dhe të thirret edhe një mbledhje e Kuvendit, edhe pse jemi në prag të fushatës për zgjedhje lokale, mandati i jonë është deri në konstituimin e përbërjes së re Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, për mua në cilësinë e kryesuesit të Kuvendit nuk ka kurrfarë pengese për me thirr edhe një mbledhje të Kuvendit, kuptohet nëse nuk ka pengesa ligjore, por nëse thirret mbledhje e kam një lutje për të gjithë këshilltarët e Kuvendit që të mos keqpërdoret, pra të mos bëhet fushat por të përqendrohemi në temat të cilat do të jenë në rend dite.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ligjërisht dihet mandati i Kuvendit andaj nuk ka kurrfarë pengese ligjore që të thirret edhe ndonjë mbledhje e Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, z. Kumrie Hoti ka herë e ka propozuar një pikë konkrete të rendit të ditës dhe do të shikojmë edhe ndonjë material tjetër apo çështje të tjera që do të mund të shqyrtoheshin në atë mbledhje.

Mirëpo, nuk jam për atë që të hiqet ndonjë pikë nga rendi i ditës ngase materialet janë dërguar me kohë edhe pse mbledhja e Kuvendit mund të zgjatë më shumë se zakonisht.

z. Kumrie Hoti, theksoi, unë nuk jam në dijeni se çfarë ka të bëjë Informata rreth shëndetësisë me fushatën zgjedhore, kjo informatë nuk është duke u kërkuar dhe e as sot por është kërkuar prej vitit 2013, andaj lidhur me këtë nuk po vërej kurrfarë politizimi për shkak të fushatës zgjedhore.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, është praktikë që gjatë fushatës zgjedhore nuk mbahen mbledhje të Kuvendit, kuptohet përveç rasteve emergjente.

z. Naim Çunaku, theksoi, pikat e rendit të ditës për këtë mbledhje dhe mbledhjen e Kuvendit janë propozuar, gjatë diskutimeve pati propozime të tjera të cilat duhet të hedhen në votim, ndërsa sa i përket propozimeve për një mbledhje tjetër të Kuvendit për këtë mund të vendosim me konsensus.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, e kuptoj se është obligim politik i Grupit të këshilltarëve të LDK – së që të mbështesin propozimet e Kryetarit të Komunës, mirëpo problemi është se ne jemi përgatitur aq sa kemi pas mundësi por shtrohet pyetja a jemi përgatitur në mënyrë të mirëfilltë për të gjitha materialët që janë propozuar në rend dite për këtë mbledhje, apo vetëm po hyjmë në mbledhje dhe po merremi me politikë, përkatësisht me akuza dhe kundër akuza.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar ditës u miratua me shumicë votash, përkatësisht 5 vota për, 3 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur.

2. Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29 qershor 2017

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Vendimit për miratimin e projektbuxhetit të komunës së Podujevës për vitin 2018 dhe parashikimet buxhetore 2019 – 2020

- **Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018**

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Bahri Blakçori, theksoi, është mjaft vështirë me folë pas një profesionisti si drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i cili në detaje e sqaroi mjaftë mirë propozimin e këtij Vendimi dhe e sqaroi situatën aktuale duke përfshirë vështirësitë dhe përparësitë e

projektbuxhetit për vitin 2018, andaj Grupi i këshilltarëve i LDK – së e përkrah këtë propozim dhe është i mendimit t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

z. Haki Rudari, theksoi, për t'i mos përsëritur gjërat në këtë mbledhje do të përqendrohesh më shkurtimisht por më gjerësisht do të diskutoj në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo tani kam vetëm një pyetje e ajo ka të bëjë me atë që tha drejtori në fjalën hyrëse lidhur me Rregulloren e tatimit në pronë se një numër i qytetarëve kanë kaluar nga zona e parë në atë të dytë dhe nga zona e dytë në atë të tretë, lidhur me këtë jam i interesuar të di se mbi çfarë baze ka ndodh kjo kur dihet se vlera për m² ndryshon sipas zonave.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, sipas Planit Zhvillimor Urban i miratuar në vitin 2012, qyteti i Podujevës është i ndarë në tri zona, deri tash në një rrugë të gjatë siç ka qenë rruga “ Skënderbeu “ kemi pasë tri zona ngase ka qenë e vështirë të përkufizohen zonat, mirëpo me sistemin e ri të adresave ekziston mundësia që në mënyrë strikte të përkufizohen zonat. Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, rendi i ditës për këtë mbledhje dhe mbledhjen e Kuvendit është i ngarkuar mirëpo kjo çështje është me rëndësi të veçantë për shqyrtim, çështje prej të cilës vlerësohet menaxhimi i Ekzekutivit të Komunës në të gjitha aspektet.

Në këtë raport një prej vërejtjeve është se Komuna ende nuk e ka caktuar një Zyrtar të lartë financiar, me këtë nënkuptohet se me më shumë punë ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, pastaj thuhet se Kryetari i Komunës është zotuar se do ta shqyrtoj Raportin e Auditimit në Asamblen Komunale si dhe për atë se deri në fund të muajit janar 2018, do ta diskutoj në Asamblen Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, pra këto janë përgjegjësi që i ka marrë Kryetari i Komunës dhe të njëjtat ne duhet t'i analizojmë.

Gjithashtu në raport është thënë, edhe pse në disa fusha kontrollet janë efektive ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin, kontratat për shërbime të veçanta dhe mbledhjen e borxheve sidomos qiranë, kjo sipas mendimit tim është vërejtje mjaft serioze dhe na bënë të nënkuptojmë se nuk mund të ndjehemi aq komod, pavarësisht që është raport i pa modifikuar por me theksim të çështjeve.

z. Isuf Latifi, theksoi, në fjalën hyrëse isha mjaftë i qartë, thash se nuk jemi plotësisht të kënaqur dhe e përmenda se ka theksim të çështjeve në kuadër të të cilave janë një numër i rekomandimeve dhe se ato rekomandime janë dhënë në bazë të dhënave të gjetura, pra nuk thash se nuk kemi pasë dobësi por thash se më gëzon fakti se opinioni i Raportit thotë, sipas mendimit tonë pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

z. Haki Rudari, theksoi, në faqen e 6 të Raportit thuhet, shpalosjet e informatave të Pasqyrave Financiare Vjetore ishin me gabime, pastaj vazhdohet, llogaritë e arktueshme për tatimin në pronë janë të paraqitura në shumë prej 2,000,534 €, ndërsa

sipas raporteve nga departamenti i tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, llogaritë e arktueshme janë 2,503,809 € dhe si rezultat i kësaj e kemi një shumë prej 503,275 € të nënvlerësuar, kjo është një shumë mjaftë e madhe, pra nuk po e thotë Hakiu se ka gabime por këtë po e thotë raporti.

z. Isuf Latifi, theksoi, ne kemi diskutuar me Auditorin kur e ka punuar draftin e raportit dhe jemi pajtuar për çështjen që e ngriti parafolësi ngase Zyra e tatimit në pronë gjatë hartimit të pasqyrave financiare përkatësisht gjatë përpunimit të të dhënave e ka bërë një gabim në diferencën e cekur të mjeteve, pra ky gabim është verifikuar dhe është pranuar por kryesorja është se nuk ka humbje materiale.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, nuk është kontestuese se raporti i Auditimit është i pa modifikuar, lidhur me këtë mund të diskutojmë dhe të paraqesim vërejtje në parim, mirëpo sipas mendimit tim nuk kemi nevojë të diskutojmë më tepër por t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të diskutojmë në detaje.

z. Naim Çunaku, theksoi, Auditori i Përgjithshëm lidhur me rregullsinë apo parregullsinë e shpenzimeve të buxhetit të Komunës e vlerëson në bazë të tri pozicioneve dhe atë mohim opinionin që është menaxhimi më i keq i mundshëm, opinion i modifikuar dhe opinionin i pa modifikuar. Në rastin e Komunës tonë shpenzimi i buxhetit është kualifikuar si opinion i pa modifikuar. Shtrohet pyetja a ka vend për përmirësim, sigurisht se ka por duhet pasë parasysh se nëse shpenzohen rreth 21 milion euro diç mund të rrjedh që nuk është në harmoni të plotë me dispozita ligjore, pra e gjitha nuk është në mënyrë të përsosur. Mirëpo ne e pranuan apo nuk e pranuan, Raportin e auditimit, e kemi me opinion të nivelit më të lartë, të pa modifikuar, andaj nuk ka vend për shqetësim dhe pretendojmë që në të ardhmen t'i eliminojmë çështjet e theksuara dhe të kemi raport edhe më të mirë.

z. Haki Rudari, theksoi, në faqen e 17 thuhet: Shpenzimi i të hyrave në vitin 2016 ishte 59%. Kjo tregon se Komuna nuk ka arritur të përfundoj projektet të cilat i ka planifikuar t'i realizoj nga të hyrat vetenake, andaj përqindja e shpenzimeve të mjeteve të cekura na bënë që të mos ndjehemi aq komod ngase unë shpesh herë kam thënë se është problem nëse nuk kemi mjete, mirëpo kur janë mjetet e ato nuk realizohen kjo nuk mund të arsyetohet.

z. Naim Çunaku, theksoi, ne të gjithë jemi dëshmitarë për shumë projekte e në mes të tyre po e përmendi projektin e Vrellës së Revuçit, projekt nëse nuk gaboje i vitit 2007 për të cilin i dimë pengesat si dhe shkaqet dhe arsyet e mosrealizimit të tij, andaj në rastet e kështilla nuk ka nevojë të na thotë askush, e as në ndonjë raport kur ne jemi në dijeni për shkaqet dhe arsyet e mosrealizimit të atij projekti. Pavarësisht nga kjo nuk mund të thuhet se gabimisht është menaxhuar buxheti nëse nuk është realizuar ndonjë projekt dhe atë për arsye objektive.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, Raporti i Auditorit të Përgjithshëm paraqet të gjeturat faktike për të cilat ne jemi pajtuar në tërësi, në përgjithësi është Raport i mirë ngase është i pamodifikuar, mirëpo çështjet me theks të veçantë, mbetet që në të ardhmen të përmirësohen.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2017

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, jam në dijeni se propozimin e kësaj Rregulloreje e kemi vu në diskutim publik para më shumë se tre muajve, është mbajtur debati me qytetarë dhe ka qenë e përgatitur për ta dërguar për shqyrtim në Kuvend, mirëpo në ndërkohë ka ardhur një Udhëzim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal sipas të cilit kjo Rregullore duhet të harmonizohet me Ligjin për Kundërvajtje, andaj kjo është arsyeja përse ky dokument nuk është dërguar deri tash për shqyrtim në Kuvend.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse. Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Propozimi i vendimit për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës

- Programi i punës për hartimin e Hartës Zonale

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, kam qenë i pranishëm me rastin e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Kryetarit të Komunës, përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfaqësuesit të GIZ – it.

GIZ – i për ofrimin e ndihmës në hartimin e Hartës Zonale i ka përzgjedh 5 apo 6 komuna në Kosovë, andaj miratimi i propozimit të këtij Vendimi është në interes të Komunës.

Pas votimit u konstatua se edhe kjo pikë e rendit të ditës njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.20’.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01- 060/04-0071735/17

**Podujevë,
18 shtator 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**